



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 147/2010

Komisioni Zgjedhor Për Ankesa dhe Prashtresa, në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Fahredin Ymeri, anëtarë, përkritazi me apelin e z Avdi Smajlaj, Sekretar i Përgjithshëm i Aleancës Kosova e Re (AKR), kundër vendimit të mëparshëm të marrë nga KZAP-i A nr.52 të datës 12.11.2009, në seancën e mbajtur me 04.05. 2010, mori:

VENDIM

REFUZOHET si i pabazuar Apeli për rishqyrtim.

ARSYETIMI

Z. Avdi Smajlaj, Sekretar i Përgjithshëm i Aleanca Kosova e Re (AKR), më datë 24.03.2010 ka parashtruar një propozim për rishikim të vendimit të KZAP-it A nr.52 të datës 12.11.2009, lidhur me mënyrën e pagimit të gjobës për shkeljen e Rregullës Zgjedhore Kodi i Mirësjelljes për Subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet NR.11/2009 neni 3.1 pika (a) duke mbuluar posterat e kandidatit të LDK-së për anëtar të asamblesë komunale te Prizrenit me posterat e kandidatit të tij për kryetar komune të Prizrenit z.Ruzhdi Rexha, për zgjedhjet e 15 nëntorit 2009. Me këtë rast ky koalicion ishte gjobitur me 3 000€ (tre mijë euro).

Sipas parashtruesit të apelit në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, në Prizren ishte lidhur një koalicion në mes të 6 subjekteve politike (AKR, LDD, BUK, BSDAK, PDAK dhe Balli Kombetar) ku si kandidat për kryetar të komunës së Prizrenit kishin nominuar z.Ruzhdi Rexha. Ndërsa në bazë të vendimit A-52/2009 të datës 12.11.2009, pagimin e gjobës për këtë shkelje e ka bërë vetëm subjekti politik AKR, me të cilën konsiderohet i dëmtuar.

Parashtruesi i Apelit, kërkon nga KZAP-i që ta rishqyrtoj Vendimin e tij A nr. 52/2009 të datës 12.11.2009, dhe shpreson që ankesë të merret parasysh pozitivisht dhe në mënyrë të drejtë nga ana e KZAP-it.

FAKTET

Më 24.03.2010, KZAP-i ka pranuar një apel me shkrim nga Z.Avdi Smajlaj, sekretar i përgjithshëm i AKR-së, me të cilën kërkon rishqyrtimin e vendimit të KZAP-it A nr. 52/2009 të datës 12.11.2009.

Ky vendim ishte bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2009, neni 3.6 ku parasheh:

3.6 Cilido subjekt politik i certifikuar duhet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin subjekteve të tjera politike të certifikuara.

Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 2 parasheh:

- 2.3 *Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.*
- 2.4 *Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.*
- 2.5 *Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre;*

z. Avdi Smajlaj , në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm AKR-së, ka sjell si provë kopjen e Deklaratës së nënshkruar të koalicionit nga ana e 6 subjekteve politike të cekura më lartë.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

KZAP konsideron se katër (4) muaj kanë kaluar mes kohës së dërgimit të apelit dhe marrjes së vendimit origjinal nga paneli i KZAP-it, më datë 12.11.2009 dhe duke vlerësuar që koalicioni nuk ka apeluar gjatë 15 ditëve të periudhës së obliguar ligjore për të paguar dënimin – deri më datë 26.11.2009, KZAP konsideron se apeli është i pa-afatshëm, prandaj si i tillë refuzohet.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 147/2010 më datën 04.05.2010

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

